

VENDIM
Nr. 841, datë 13.12.2006

**PËR PAGESËN E ANËTARËVE, NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE PËR
VLERËSIMIN, MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE
DHE TË MATERIALEVE TË TJERA NDIHMËSE, NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR**

(Ndryshuar me VKM nr. 71, datë 7.2.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 52 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët, në përbërje të bordit të miratimit të teksteve shkollorë, për periudhën e veprimtarisë së bordit, të paguhet me 30 për qind të pagës mujore të “Doktorit të Shkencave”, në universitetet dhe shkollat e larta, ndërsa kryetari i bordit me 30 për qind të pagës mujore, të “Profesorit”, në universitetet dhe shkollat e larta.

2. Vlerësuesit e teksteve, të aktivizuar për kryerjen e procesit të vlerësimit, miratimit dhe certifikimit të teksteve shkollorë, të paguhet, përkatësisht, sipas punës (për çdo tekst), po jo më shumë se 3 persona për secilën kategori vlerësimi, *duke përjashtuar nga ky rregull pagesën për anëtarët e aktivizuar gjatë vitit 2006:*

- | | |
|---|-------------|
| a) Për vlerësim shkencor | 4 000 lekë; |
| b) Për vlerësim gjuhësor | 3 000 lekë; |
| c) Për vlerësimin e metodologjisë | 3 000 lekë; |
| ç) Për vlerësim dizanji | 1 500 lekë; |
| d) Për vlerësim krahasues të njëjtësisë dhe ndryshimeve | 1 000 lekë. |

3. Specialistët a punonjësit, e thirrur pranë bordeve, komisioneve apo grupeve të punës, me kërkesë të bordit të miratimit të teksteve, për mbështetje teknike dhe veprime sekretarie, në periudhat e miratimit të teksteve, të paguhet, sipas normave, për punën e kryer jashtë kohës normale të punës.

4. *Shfuqizuar.*

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha